



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 362/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.09.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “W.Center” shpk nga procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me nr.REF-58793-05-21-2020, me objekt “*Blerje materiale të nevojshme për mbrojtjen personale për përballimin e situatës të shkaktuar nga COVID-19*”, me fond limit 37 546 021 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 02.07.2020 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së BOE “Captain Din” shpk & “Gentian Horieti” p.f nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues: “W Center” shpk
Rruga “Dritan Hoxha”, Pallati “Teknoprojekt” Building
pranë “Ring Center”, Tiranë

BOE “Gentian Horieti” p.f & “Captain Din” shpk
Komuna e Parisit Nr.8 Tiranë

Autoriteti Kontraktor:	Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë Rr. “Barrikadave”
Baza Ligjore:	Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjeve, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

I.4. Operatorët ekonomikë kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 21.05.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me nr.REF-58793 – 05 – 21 – 2020, me objekt “*Blerje materiale të nevojshme për mbrojtjen personale për përballimin e situatës të shkaktuar nga COVID-19*”, me fond limit 37 546 021 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 02.07.2020 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 02.07.2020 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 17.07.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

- Florifarma shpk	25,119,810	I skualifikuar
- Shpiragu shpk	29,880,600	I skualifikuar
- Farma Net Albaniashpk	29,971,640	I skualifikuar
- W Center shpk	34,304,070	I skualifikuar
- Captain Din&Gentian Horieti shpk	34,538,670	I skualifikuar
- Euro Mega 2020 shpk	36,432,300	I skualifikuar
- Egian Med shpk	36,439,590	I skualifikuar
- Malbertex shpk	36,481,860	I skualifikuar
- Fedos shpk	37,500,066	I skualifikuar

II.4. Në datën 17.07.2020 operatori ekonomik “*Ë Center*” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsye si më poshtë vijon.

- *Kriteret e veçanta pika 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6, 2.3.7 operatori ekonomik në përmbushje të këtyre kriterëve duhej të kishte paraqitur në sistem dokumentacion të noterizuar dhe jo fotokopje me vërtetim përkthimi. Kusht ky skualifikues referuar DST.*

II.5. Në datën 23.07.2020 operatori ekonomik “*W Center*” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor lidhur me skualifikimin e ofertës së tij, në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- Në lidhje me këtë arsye skualifikimi nuk jemi dakord për arsyet që po ju parashtrojmë më poshtë:
- Së pari sipas DT rezulton se arsyeja e skualifikimit pretendohet se qëndron në lidhje me mospërbushjen nga operatori ekonomik i kritereve të përcaktuara si më poshtë citojmë nga DT.

2.3.4 Operatori ekonomik për artikullin:

- Maska prej pëlhure

Duhet të paraqesë dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, raport analizë, ku të jenë analizuar treguesit teknik të kërkuar në specifikimet teknike, të kryera nga ISHTI ose Institucione të tjera të Autorizuara që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Në raport analizë duhet të identifikohet plotësisht mostra e analizuar. Copa e përdorur për artikullin mostër dhe ajo që i bashkangjitet raport analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë skedat teknike për artikujt:

- Doreza njëpërdorimshe
- Sapun i lëngshëm për duart
- Xhel dezinfektues për duart

Në skedën teknike të produktit duhet të dallohet qartë përputhja e të gjitha karakteristikave të kërkuara në specifikimet teknike me produktet e ofruara.

2.3.6 Ditën e zhvillimit së tenderit, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Një mostër për secilin artikull të kërkuar, objekt i këtij prokurimi.
- Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë D. P. Ç. K - ve, Rruga e Barrikadave, Çerdhja nr.1 Tiranë.
- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.
- Mostrat duhet të jene ne përputhje me te gjitha specifikimet teknike te kerkuara.
- Për artikullin “maskë prej pëlhure”, raport analiza e kërkuar duhet të paraqitet origjinale.

- 2.3.7 Në lidhje me artikullin sapun i lengshem per duart, Operatori Ekonomik duhet te paraqese Çertifikatë te aprovimit te testimit dermatologjik, leshuar nga organizma te akredituara me qellim vertetimin e testimit dermatologjik. (shtuar në DT me shtojcën e datës 19.06.2020)

- Për kriterin e parashikuar në pikën 2.3.4
 Në përmbushje të këtij kriteri ne kemi paraqitur për këtë procedurë prokurimi dokumentin Raport Testimi të lëshuar nga UPT Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike Departamenti i Tekstilit dhe Modës. Është lehtësisht e dallueshme se raporti i testimit është dorëzuar i skanuar në origjinal dhe për këtë nuk ka asnjë mundësi intepretimi. Në lidhje me arsyen e skualifikimit për këtë kriter duke se AK është shprehur gabim pasi nuk rezulton që as të jetë dorëzuar ndonjë dokument që ka nevojë të jetë i përkthyer pasi është në gjuhën shqipe apo të jetë i noterizuar pasi sic e shpjeguam është dorëzuar në origjinal. Për këtë arsye pretendimi i ngritur për këtë pikë nuk qëndron.

- Për kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.5
 Në përmbushje të këtij kriteri ne kemi paraqitur për këtë procedurë prokurimi këto dokumenta:
 Dokumentin me emërtim “Sempermed raport analizë”
 Dokumentin “Sempermed CE”
 Dokumenti “Sempermed SDS”
 Dokumentin “Diversey SDS”
 Dokumenti “Test Dermatologjik”
 Dokumenti “Diversey raport analizë”
 Dokumenti “Diversey raport analizë”
 Në këto dokumenta janë paraqitur të dhënat teknike të materialeve të kërkuara. Këto dokumenta në origjinalin e tyre janë në gjuhën angleze dhe nga ana jonë ato janë paraqitur të përkthyer në shqip. Sic rezulton nga dokumentat e ngarkuara në sistem ato noterizime janë bërë pranë noterit Ilir Qejvani dhe janë përkthyer nga përkthyesja e autorizuar Iliona Qejvanaj dhe ky fakt vërtetohet nga noteri. Dokumentat janë të vulosur në cdo faqe dhe përmbajnë të gjithë elementët e vlefshmërisë.
 Përvec kësaj nga ana jonë janë paraqitur në sistemin elektronik edhe dokumenta origjinalë në gjuhën angleze në mënyrë që autoriteti në cdo kohë të kishte mundësinë të konstatonte se ato ishin të njëjta me dokumentat e noterizuar.
 Gjithashtu vlen të theksohet se kemi të bëjmë me dokumenta teknike të cilat sot janë të aksesueshme online në faqet zyrtare të kompanive prodhuese dhe që në cdo kohë mund të verifikohen . Dokumentat teknike janë pjesë e ofertës që operatori përgatit duke dhënë garanci rreth të dhënave që paraqet si dhe duke mbajtur përgjegjesi që mund të vijnë më pas nga mospërmbushja e specifikimeve teknike të paraqitura në dokumentacionin e shkruar.
 Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që të ketë mundësinë që në vlerësimin e ofertave të kuptojë në gjuhën shqipe të gjithë dokumentacionin e paraqitur dhe që përmban të dhëna teknike.

Gjithashtu në lidhje me këtë çështje ka një qëndrim të konsoliduar të KPP i cili ka krijuar tashmë një praktikë në lidhje me këtë rast.citojmë vendimin nr.528/2017,116/2016. Për këtë arsye pretendimi për këtë pikë nuk qëndron.

- *Për kriterin e parashikuar në pikën 2.3.6
Kriteri i parashikuar në këtë pikë ka të bëjë me dorëzimin e mostrave dhe nuk ka asnjë lidhje me dorëzimin e ndonjë dokumentacioni për përmbushjen e tij. Për këtë arsye pretendimi i ngritur për këtë pikë nuk qëndron.*
- *Për kriterin e parashikuar në pikën 2.3.7
Për përmbushjen e këtij kriteri kemi paraqitur testin deramtologjik i cili është i përkthyer nga noteri dhe për këtë pikë vlejné të gjitha arsyetimet që kemi bërë më sipër për pikën 2.3.5 në lidhje me noterizimin e dokumentacionit. Për sa më sipër edhe pretendimi për këtë pikë nuk qëndron.*

Sa më sipër kërkojmë pranimin e ankesës dhe rivlerisimin e ofertave duke kualifikuar ofertën tonë.

II.6. Në datën 27.07.2020 operatori ekonomik ankimues “W Centër” shpk ka marrë dijëni lidhur me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 05.08.2020 pala ankimuese “W Center” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.8. Në datën 17.07.2020 BOE “Captain Din” shpk & “Gentian Horieti” p.f është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon.

- *Kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.3.1, operatori ekonomik Gentian Horieti, anëtar i këtij bashkimi operator nuk e përmbush këtë kriter. Kontratat e paraqitura për këtë kriter nga ky operator, kanë artikuj jo të ngjashëm, si dhe një kontratë nuk ka vërtetim realizimi. Vlera totale nga faturat tatimore dhe artikujt e ngjashëm objekt i këtij prokurimi, nuk e arrin përqindjen respektive të këtij operatori, për këtë kriter.*

II.9. Në datën 24.07.2020 BOE “Captain Din” shpk & “Gentian Horieti” p.f shpk ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Për sa i përket arsyes së skualifikimit mendojmë që nuk është e bazuar në fakte dhe bazën ligjore ne fuqi nenin 27 pika 4 e VKM nr.914 datë 29.12.202014 e ndryshuar.*
- *Nga shqyrtimi literal i dispozitës del qartë se ligjvënësi nuk përcakton mundësinë e AK për të kërkuar furnizime të mallrave të njëjta por të ngjashmedhe rrjedhimisht për*

tu plotësuar nga operatori ekonomik sipas kësaj kërkesë. Nuk e kuptojmë se si nuk mund të konsiderohen të ngjashme kontratat e furnizimit me materiale higjieno sanitare.

- Të dyja këto grup produktesh si ato të kërkuara nga AK dhe ato të paraqitura me anë të kontratave të ngjashme nga BOE klasifikohen në grupin e produkteve për mbrojtjen personale nga papastërtitë dhe infeksionet e mundshme me përdorim të qartë higjieno sanitar. Ne si BOE kemi vërtetuar me kapacitetet tona që jo vetëm kemi furnizuar autoritetet kontraktore dhe subjekte private me këto produkte por dhe i kemi dorëzuar ato me korrektësi në afat dhe cilësi të konfirmuara dhe nga autoritetet kontraktore dhe i kemi paraqitur këto në mënyrë elektronike.
- Gjykojmë se AK nuk duhet të vlerësojë në mënyrë sipërfaqësore ngjashmërinë e kontratave por duhet të analizojë elementët konkretë të furnizimeve të kryera më parë referuar kontratave të ngjashme. AK në procesin e shqyrtimit të kontratave të paraqitura për eksperiencë të ngjashme duhet të fokusohet jo vetëm në titullin apo objektin e kontratës së ngjashme por duhet të analizojë të gjitha zërat e mallrave të kontratave të paraqitura për të verifikuar dhe konkuduar më pas në evidentimin e zërave të tillë të ngjashëm në kontratat e realizuara më parë. AK nuk duhet të pretendojë për zëra të njëjtë shërbimi në kundërshtim me RrPP.
- Furnizimet e ngjashme të paraqitura /depozituara nga anëtari i BOE Gentian Horjeti pf për këtë procedurë janë më të mëdha si nga ana sasiore ashtu edhe nga ana cilësore dhe profesionale e realizimit të tyre në proporcion me cilësinë dhe sasinë e mallrave objekt prokurimi.
- Operatori ekonomik Gentian Horjeti pf si anëtar i BOE ka depozituar në SPE kontrata të ngjashme dhe fatura me artikuj të ngjashëm në vlerë më tepër se 40 % të verës së fondit limit referuar kriterit 2.3.1.
- Konkretisht janë depozituar fatura dhe kontrata me verë në total 22,477,784 lekë pa tvsh
- Fatura Gentian Horjeti pf në vlerën 1,664,186 lekë pa tvsh me artikuj të ngjashëm, doreza nitrile, veshje njëpërdorimshe, veshje speciale për DDD, xhel dezinfektues, sapun të lëngët antibakterial, maska dhe materiale pastrimi.
- Kontrata nr. 10/2 datë 21.05.2020 me objekt Blerje pajisje për mbajtjen e produkteve higjienizuese me vlerë 657,820 lekë pa tvsh
- Kontrata me nr.6/10 datë 23.04.2020 me objekt Blerje veshje pune për DDD në vlerë 2,198,500 lekë pa tvsh
- Kontrata Nr. 159/17 dat 08.04.2019 me objekt “Blerje uniforma dhe veshje speciale” me vlerë 4,785,000 lekë pa tvsh
- Kontratë nr. 1058/1 datë 30.03.2020 me objekt Blerje uniforma dhe veshje speciale, me vlerë 5,597,800 lekë pa tvsh
- Kontratë nr. 42/4 datë 15.12.2017 me objekt Blerje uniforma dhe veshje speciale, me vlerë 715,800 lekë pa tvsh
- Kontratë nr. 6/8 datë 23.04.2020 me objekt Blerje mjete pune për DDD me vlerë 789,510 lekë pa tvsh
- Kontratë nr.557/14 datë 10.04.2018 me objekt Blerje uniforma dhe veshje speciale me vlerë 3,275,833 lekë pa tvsh

- Kontratë nr.28/7 datë 16.07.2018 me objekt Blerje uniforma dhe veshje speciale me vlerë 897,550 lekë pa tvsh
- Kontratë nr.30/5 datë 02.12.2019 me objekt Blerje uniforma veshje speciale në vlerë 1,895,785 lekë pa tvsh
- Vlerën e kontratave dhe faturave me artikuj të ngjashëm ligji e lejon të jetë edhe më pak se 40% e vlerës së kontratës që prokurohet.
- Në rastin konkret ky parashikim ligjor nuk është marrë parasysh nga AK duke ju referuar edhe faktit që situata e covid 19 është një situatë e fatkeqësisë natyrore e ndodhur gjatë vitit 2020 dhe këto produkte identike janë tregtuar vetëm në 2020 dhe jo në vitet e mëparshme megjithatë referuar kontratave dhe faturave tatimore OE Gentian Horieti pf e plotëson këtë kriter të detajuar sipas kontratave dhe faturave më lart.
- Edhe anëtari tjetër i bashkimit tonë Captain Din ka plotësuar një vlerë prej 16,267,103 lekë pa tvsh në fatura dhe kontrata ku artikujt janë identikë si këto që ju prokuroni xhel, dezinfektues, sapun likuid antibakterial, maska të llojeve të ndryshme, doreza nitrile, termometra etj.
- Nëse do të përdorej standarti që do të konsideroheshin të ngjashme materialet e pastrimit detyrimisht edhe produktet e kontratave tona janë të ngjashme me produktet që ju prokuroni pasi ligji e kërkon të ngjashme dhe jo identike edhe pse ne kemi produkte identike në vlerë më tepër se 40% e fondit limit.
- Për sa i përket konstatimit të AK që një kontratë e ngjashme nuk ka vërtetim realizimi pranojmë që është konstatuar në mënyrë të drejtë ky fakt por gjithashtu sjellim në vëmendje të AK se dhe pa llogaritur vlerën e kësaj kontrate vlera e kontratave të ngjashme të paraqitura e tejkalon ndjeshëm vlerën e kërkuar nga AK. Vlera e kërkuar e kontratave të ngjashme 40 e FL është rreth 13,000,000 lekë pa tvsh kurse vlera e kontratave të ngjashme të paraqitura nga Gentian Horjei pf rezulton mbi 18,000,000 lekë pa tvsh.
- Sa më sipër kërkojmë rivlerësimin e procedurës duke kualifikuar ofertën tonë dhe duke e shpallur atë fituese.

II.10. Në datën 27.07.2020 me shkresën nr.ska prot autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje BOE ankimues ku ka vendosur mospranimin e ankesës. BOE ankimues pretendon se ka marrë dijëni lidhur me përgjigjen e autoritetit kontraktor në datë 04.08.2020 me poste rekomande.

Lidhur me këtë fakt KPP gjykoi të arsyshme ti kërkojë BOE ankimues paraqitjen e provave lidhur me marrjen dijëni të përgjigjes së autoritetit kontraktor më datë 04.08.2020. Në datën 02.09.2020 me anë të shkresës protokolluar me tonën me nr.901/4 BOE Captain Din shpk & "Gentian Horieti" shpk ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik Lajmërim Marrje Postare Nr.837/4 nga ku rezulton se BOE ankimues ka marrë dijëni lidhur me përgjigjen e autoritetit kontraktor më datë 04.08.2020.

Sa më sipër, llogaritja e afateve kohore mbi dorëzimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues pranë institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik nis ditën e nesërme pas përfundimit të afatit kohor të autoritetit kontraktor mbi trajtimin e ankesës dhe përfundon në ditën e 10-të. Sa më sipër, akesa e operatorit ekonomik ankimues dorëzuar pranë Komisionit

të Prokurimit Publik në datën 10.08.2020 është brenda afateve ligjore duke u legjitimuar *ratione temporis*.

II.11. Në datën 10.08.2020 BOE ankimues “Captain Din” shpk & “Gentian Horieti” p.f, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.12. Nëpërmjet shkresës nr.831/7 prot datë 14.08.2020 protokolluar me tonën me nr.881/2 prot datë 14.08.2020 dhe 881/3 datë 17.08.2020 me objekt “*Dërgohet informacioni*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “W Center” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “*Kriteret e veçanta pika 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6, 2.3.7 operatori ekonomik në përmbushje të këtyre kriterëve duhej të kishte paraqitur në sistem dokumentacion të noterizuar dhe jo fotokopje me vërtetim përkthimi. Kusht ky skualifikues referuar DST, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Në shtojcën 9 “*Kriteret e vecanta të kualifikimit*” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohen kriteret si më poshtë:

2.3.4 Operatori ekonomik për artikullin:

- *Maska prej pëlhure*

Duhet të paraqesë dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, raport analizë, ku të jenë analizuar treguesit teknik të kërkuar në specifikimet teknike, të kryera nga ISHTI ose Institucione të tjera të Autorizuara që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Në raport analizë duhet të identifikohet plotësisht mostra e analizuar. Copa e përdorur për artikullin mostër dhe ajo që i bashkangjitet raport analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

2.3.5. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë skedat teknike për artikujt:

- Doreza njëpërdorimshe
- Sapun i lëngshëm për duart
- Xhel dezinfektues për duart

Në skedën teknike të produktit duhet të dallohet qartë përputhja e të gjitha karakteristikave të kërkuara në specifikimet teknike me produktet e ofruara.

2.3.6. Ditetën e zhvillimit së tenderit, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Një mostër për secilin artikull të kërkuar, objekt i këtij prokurimi.
- Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë D. P. Ç. K - ve, Rruga e Barrikadave, Çerdhja nr.1 Tiranë.
- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.
- Mostrat duhet të jene ne perputhje me te gjitha specifikimet teknike te kerkuara.
- Për artikullin “maskë prej pëlhere”, raport analiza e kërkuar duhet të paraqitet origjinale.

III.1.2. Në shtojcën “modifikim mbi dokumentat e tenderit” të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Pika 2.3 Kapaciteti teknik.

- I. Ndryshohet pika 2.3.5 dhe shtohet pika 2.3.7 e shtojcës Nr. 9 “**Kapaciteti teknik**” për “**Blerje materiale të nevojshme për mbrojtjen personale për përballimin e situatës të shkaktuar nga COVID-19**”, si më poshtë:

Kriteri 2.3.5 i shtojcës Nr. 9 “Kapaciteti teknik” ndryshon si më poshtë:

2.3.5.1. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Skedën teknike për artikullin:

- Doreza njëpërdorimshe

Në skedën e produktit të sipërpërmendur, duhet të dallohet qartë përputhja e të gjitha karakteristikave të kërkuara në specifikimet teknike me produktin e ofruar. Skeda e produktit duhet te tregojë që parametrat e produktit janë ne perputhje me normativat dhe standartet kombetare dhe/ose nderkombetare në fuqi.

2.3.5.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Skedën teknike dhe Skedën e sigurisë për artikullin:

- *Sapun i lëngshëm për duart*

Në skedat e produktit të sipërpërmendur, duhet të dallohet qartë përputhja e të gjitha karakteristikave të kërkuara në specifikimet teknike me produktin e ofruar. Skedat e produktit duhet të tregojnë që parametrat e produktit janë në përputhje me normativat dhe standartet kombetare dhe/ose nderkombetare në fuqi.

2.3.5.3. *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Skedën teknike dhe skedën e sigurisë për artikullin:*

- *Xhel dezinfektues për duart*

Në skedat e produktit të sipërpërmendur, duhet të dallohet qartë përputhja e të gjitha karakteristikave të kërkuara në specifikimet teknike me produktin e ofruar. Skedat e produktit duhet të tregojnë që parametrat e produktit janë në përputhje me normativat dhe standartet kombetare dhe/ose nderkombetare në fuqi.

Shtohet kriteri 2.3.7 i shtojcës Nr. 9 “Kapaciteti teknik” si më poshtë:

2.3.7 *Në lidhje me artikullin sapun i lëngshëm për duart, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë të aprovimit të testimit dermatologjik, leshuar nga organizma të akredituara me qëllim vertetimin e testimit dermatologjik.*

III.1.3. Në shtojcën 10 “Specifikimet teknike” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

1. Maska prej pëlhure

Maska duhet të jetë shumëpërdorimshe për të rritur, e prodhuar me material pëlhure që lahet në temperaturën 60 °C dhe hekuroset.

Maska duhet të jetë me llastik pas veshit ose pas kokës, të puthitet lehtësisht me fyrrë dhe hundën, të mbrojë hundën dhe gojën.

Maska duhet të përmbajë identifikimin e prodhuesit.

Ky artikull duhet të shoqërohet me raport analizë.

2. Doreza njëpërdorimshe

Doreza Latex ose Nitrile, josterile, me ose pa pudër, njëpërdorimshe, në masat XS, S, M, L, XL (sipas kërkesës së punonjësve), të jenë të paketuara në pako kartoni ose plastike, me minimum 100 copë doreza. Të ketë certifikimin CE ose FDA ose ekuivalent. Afati i skadencës të jetë të paktën 6 muaj nga koha e furnizimit. Të ambalazhuar në mënyrë të tillë që të mos kontaminohen gjatë shpërndarjes.

Të dhënat dhe parametrat e parashikuar më sipër duhen të jenë përcaktuar në skedën teknike të produktit.

3. Sapun i lëngshëm për duart.

Sapun i lëngshëm, antibakterial ose anti-mikrobiale me glicerinë, me aftësi shkumuese të lartë, lartësia e shkumës jo më e vogël se 5 cm, e butë për lëkurën dhe e testuar dermatologjikisht. Ambalazhimi në konfeksion plastik 0.5 – 1 litër (me mekanizëm sprucimi). Afati i skadencës të jetë jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit.

Të dhënat dhe parametrat e parashikuar më sipër duhen të jenë përcaktuar në skedën teknike të produktit.

4. Xhel dezinfektues për duart.

Material xhel për dezinfektimin e duarve, me bazë alkooli të paktën 60%, antiseptik i shpejtë dhe dezinfektues efektiv, i gatshëm për t,u përdorur pa nevojën e përdorimit të ujit për shpëlarje, antibakterial ose anti-mikrobiale për zvogëlimin e shkaktarëve të infeksioneve.

Paketikimi: Bidon plastik me mekanizëm sprucimi 0.5- 1 litër. Afati i skadencës të jetë jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit.

Të dhënat dhe parametrat e parashikuar më sipër duhen të jenë përcaktuar në skedën teknike të produktit.

III.1.4. Në shtojcën modifikim mbi dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

II. Në shtojcën Nr. 10 të DST – së “Specifikimet Teknike” bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Maska prej pëlhure

Maska duhet të jetë shumëpërdorimshe, e prodhuar me material pëlhure, që lahet në temperaturën 60 °C dhe të hekuroset.

Maska duhet të jetë e qepur me palosje, në mënyrë që pasi vendoset në fytyrë, të lejojë hapjen e saj për të mbuluar lehtësisht hundën dhe gojën.

Maska duhet të jetë me llastik pas veshit ose pas kokës, të puthitet lehtësisht me fytyrën dhe hundën, të mbrojë hundën dhe gojën.

Përmasat e maskës duhet të jenë si më poshtë:

Gjatësia 17-21 cm

Gjerësia 7-9 cm

Maska duhet të përmbajë indentifikimin e prodhuesit.

Ky artikull duhet të shoqërohet me Raport Analizë.

2. Dorëza njëpërdorimshe

Doreza Latex ose Nitrile, josterile, me ose pa pudër, njëpërdorimshe, në masat S, M, L, XL (sipas kërkesës së AK), të jenë të paketuara në pako kartoni ose plastike, me minimumi 100 copë doreza. Të ketë certifikimin CE ose FDA ose ekuivalent.

Afati i skadencës të jetë te paktën 6 muaj nga koha e furnizimit. Të ambalazhuar në mënyrë të tillë që të mos kontaminohen gjatë shpërndarjes

Për këtë produkt Operatori Ekonomik duhet të paraqesë skedën teknike.

Të dhënat dhe parametrat e parashikuara më sipër duhen të jenë të përcaktuara në skedën teknike të produktit.

Skeda e produktit duhet të tregojnë që parametrat e produktit janë në përputhje me normativat dhe standartet kombetare dhe/ose nderkombetare në fuqi.

3. Sapun i lëngshëm për duart

Sapun i lëngshëm, antibakterial ose antimikrobial me glicerinë, me aftësi shkumuese të lartë, lartësia e shkumës jo më e vogël se 5 cm, e butë për lëkurën dhe e testuar dermatologjikisht, vërtetuar kjo, me certifikate të aprovimit të testimit dermatologjik, lëshuar nga organizma të akredituara.

Ambalazhimi në konfeksion plastik 0.3 – 1 litër (me mekanizëm sprucimi)

Produkti duhet të plotësojë parametrat e mëposhtëm:

Përmbajtja e joneve H^+ pH 5-7

Densiteti 1-1.05 g/ml

Tretshmeria ne uje: 100%

Paraqitja fizike e solucionit: Lëng viskoz, homogjen.

Ambalazhimi: Ambalazhim fabrike ku të jetë përcaktuar emërtimi dhe kodi i prodhuesit.

Data e skadencës jo me pak së një vit kalendarik nga data e lëvrimit te produktit.

Për këtë produkt Operatori Ekonomik duhet të paraqesë skedën teknike dhe skedën e sigurisë. Të dhënat dhe parametrat e parashikuara më sipër duhen të jenë të përcaktuara në skedat përkatëse të produktit.

Skedat e produktit duhet te tregojnë që parametrat e produktit janë ne perputhje me normativat dhe standartet kombetare dhe/ose nderkombetare në fuqi.

4. Xhel dezinfektues për duart.

Material xhel për dezinfektimin e duarve, me bazë alkooli të paktën 60%, antiseptik i shpejtë dhe dezinfektues efektiv, i gatshëm për t'u përdorur pa nevojën e përdorimit të ujit për shpërlarje, antibakterial ose anti-mikrobial për zvogëlimin e shkaktarëve të infeksioneve. Ambalazhimi në konfeksion plastik 0.3 – 1 litër (me mekanizëm sprucimi)

Produkti duhet të plotësojë parametrat e mëposhtëm:

Përmbajtja e joneve H^+ pH 5-6
Densiteti 0.8 -0.9 gr/ml

Ambalazhimi: Ambalazhim fabrike ku të jetë përcaktuar emërtimi dhe kodi i prodhuesit.

Data e skadencës jo me pak së një vit kalendarik nga data e lëvrimit te produktit.

Për këtë produkt Operatori Ekonomik duhet të paraqesë skedën teknike dhe skedën e sigurisë. Të dhënat dhe parametrat e parashikuara më sipër duhen të jenë të përcaktuara në skedat përkatëse të produktit.

Skedat e produktit duhet te tregojnë që parametrat e produktit janë ne perputhje me normativat dhe standartet kombetare dhe/ose nderkombetare në fuqi.

III.1.5. Në shtojcën 12 “Sasia dhe Grafiku i Lëvrimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Sasia e mallit që kërkohet:

Sasia totale e mallit që do të lëvrohet është sipas listës së mëposhtme.

Malli do të lëvrohet me kërkesën e Autoritetit Kontraktor.

Sasia e mallit që do të lëvrohet do të përcaktohet në kërkesën e Autoritetit Kontraktor, duke patur parasysh nevojat e çerdheve dhe kopshteve në zbatim të normativave të miratuara dhe kapacitetit magazinues të AK, parashikuar në kontratat respektive të Marrëveshjes Kuadër.

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia Totale
-----------	-----------------	---------------	---------------------

1	Maska prej pëlhure	copë	39 600
2	Doreza njëpërdorimshe	copë	1 742 400
3	Sapun i lëngshëm për duart	litra	27 588
4	Xhel dezinfektues për duart	litra	6 363

Afatet e lëvrim:

Referuar kohëzgjatjes së periudhës së pandemisë, afati i lëvrim të mallrave do të jetë sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, që nga data e lidhjes së kontratës deri në përfundim të periudhës 12 Mujore të MK.

III.1.6. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezultojnë se operatori ekonomik ankimesh në Centershpk në përmbushje të kriterëve 2.3.4,2.3.5,2.3.6,2.3.7 sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- 2.3.4. Fletë Analizë Nr.A2-252 datë 26.06.2020 lëshuar nga Univeristeti Politeknik i Tiranës Departamenti i tekstit dhe Modës për testimin e kampionit A2-252 ardhur më datë 24.06.2020 rezultojnë se përfaqëson artikullin Maskë shumëpërdorimshme material tekstil me thurje garniturë dhe përbërje 65% poliestër dhe 35% pambuk e qëndrueshme pas hekurrosjes. Gjatësia 172 cm, Gjërësia 70mm.
- 2.3.5. Skedat teknike të prodhuesit Diversey dhe Semperit Technische Produkte Gesellschaft m.b.H. në gjuhën angleze të përkthyer nga përkthyes i licensuar vërtetuar me akt noterial vërtetimi për produktet Doreza Mbrojtëse, Xhel deinfektues për duart, sapun i lëngshëm për duart.
- 2.3.6. Ka të bëjë me dorëzimin e mostratve ditën e zhvillimit të tenderit.
- 2.3.7. Raport Studimi në gjuhën angleze e përkthyer në gjuhën shqipe vërtetuar me vërtim përkthimi noterial - Testim tek njerëzit për përshatshmërinë me lëkurën e një produkti kozmetik pas përdorimit të vetëm –Testim mostre nën kontroll dermatologjik-Qendra e Investigimit Evic France.

III.1.7. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”

III.1.8. Në nenin 23 pika 1, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se : “1. *Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.*

III.1.9. Në nenin 27 pika 6 e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, “Kontratat e Mallrave” parashikohet shprehimisht se:

Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;*
- b) *dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike;dhe/ose*
- c) *dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

III.1.10. Në Manualin nr.1, datë 26.01.2018 “Për rregjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronik”, hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, në faqen 17 e tij, paragrafi i parë thuhet se: “Dokumentat e skanuar duhet të jenë origjinal ose kopje e noterizuar, versioni i skanuar i këtyre dokumentave pasi hidhet në sistemin e prokurimit elektronik, për një procedurë konkrete është i barasvlefshëm me dokumentin origjinal ose kopjen e noterizuar”.

III.1.11. Në Udhëzimin e APP-së nr.3, datë 09.05.2017 “Për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Ofertave në Prokurimin me Mjete Elektronike”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorit ekonomik të shpallur fitues, përpara lidhjes së kontratës, i kërkohet të paraqesë dokumentacionin administrativo ligjor në formë të shkruar të paraqitur në tender (origjinal ose fotokopje e noterizuar), i cili, verifikohet nga KVO-ja dhe bëhet pjesë e dosjes së tenderit.”

III.1.12. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “W Center” sh.p.k në SPE, rezulton se ky i fundit, në përmbushje të kriterëve të mësipërme të kualifikimit, ka paraqitur skeda teknike për produktet objekt prokurimi në gjuhën angleze të përkthyer në gjuhën shqipe nga një përkthyes i licensuar i njohur para noterit në të cilat konstatohet se produktet e ofruara i përkasin kompanive prodhuese *Diversey dhe Sepremed*.

Artikujt në katalog rezultojnë me të gjitha karakteristikat teknike të tyre në gjuhën angleze dhe të përkthyer në gjuhën shqipe. Katalogu është shoqëruar me përkthim në mënyrë që autoriteti kontraktor lehtësisht të mund të verifikonte përputhshmërinë e të dhënave me specifikimet teknike të kërkuara.

III.1.13. Gjithashtu sa i takon kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.4 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, KPP vëren se të është kërkuar që operatorët ekonomikë për artikullin: *Maska prej pëlhure duhet të paraqesë dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, raport analizë, ku të jenë analizuar treguesit teknik të kërkuar në specifikimet teknike, të kryera nga ISHTI ose Institucione të tjera të Autorizuara që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Në raport analizë duhet të identifikohet plotësisht mostra e analizuar. Copa e përdorur për artikullin mostër dhe ajo që i bashkangjitet raport analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta*. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike sikundër më lart pasqyruar operatori ekonomik ankimues “W Center” shpk ka paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri Fletë Analizë Nr.A2-252 datë 26.06.2020 lëshuar nga Univeriteti Politeknik i Tiranës Departamenti i tekstilit dhe Modës për testimin e kampionit A2-252 ardhur më datë 24.06.2020 rezulton se përfaqëson artikullin maskë shumëpërdorimshme material tekstil me thurje garniturë dhe përbërje 65% poliestër dhe 35% pambuk e qëndrueshme pas hekurossjes. Gjatësia 172 cm, Gjërësia 70mm. Në këtë kuptim konstatimi i autoritetit kontraktor se dokumenti nuk është njehsuar me origjinalin para noterit është tërësisht i pabazuar pasi dokumenti i hedhur në sistem sikundër pretendon edhe ankimuesi është në version origjinal në përputhje me ushëzimin e APP i cili parashikon shprehimisht se *Dokumentat e skanuar duhet të jenë origjinal ose kopje e noterizuar, versioni i skanuar i këtyre dokumentave pasi hidhet në sistemin e prokurimit elektronik, për një procedurë konkrete është i barasvlefshëm me dokumentin origjinal ose kopjen e noterizuar*”. KPP gjykon se autoriteti kontraktor ka dhënë një argument të pabazuar dhe në rastin konkret duhet të fokusohet në verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike me të dhënat që përmban dokumentacioni i dorëzuar nga ankimuesi dhe jo të gjykonte mbi vlerën e dokumentit të skanuar në format origjinal.

III.1.14. Akoma më tej kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.6 për të cilin autoriteti kontraktor ka dhënë të njëjtat argumenta skualifikimi pra mungon dokumenti i njehsimit me origjinalin KPP vëren se në këtë pikë të kriterit autoriteti kontraktor ka kërkuar *Ditën e zhvillimit së tenderit, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Një mostër për secilin artikull të kërkuar, objekt i këtij prokurimi. Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë D. P. Ç. K - ve, Rruga e Barrikadave, Çerdhja nr.1 Tiranë. Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik. Mostrat duhet të jene në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të*

kerkuara. Për artikullin “maskë prej pëlhure”, raport analiza e kërkuar duhet të paraqitet origjinale.

Sa më sipër KPP gjykon se me të drejtë akimuesi ka pretenduar *Për kriterin e parashikuar në pikën 2.3.6 Kriteri i parashikuar në këtë pikë ka të bëjë me dorëzimin e mostrave dhe nuk ka asnjë lidhje me dorëzimin e ndonjë dokumentacioni për përmbushjen e tij. Për këtë arsye pretendimi i ngritur për këtë pikë nuk qëndron.* Nëse autoriteti kontraktor i referohet raport analizës e cila duhet të paraqitet origjinale KPP i qëndron arsyetimit më lart ku nga verifikimi në SPE dokumenti Fletë Analizë është skanuar në origjinal dhe nuk ka asnjë dyshim lidhur me këtë fakt.

III.1.15. Sa i takon kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.7 të shtuar në shtojcën për modifikim të dokumentave të tenderit KPP vëren se në të kërkohet *Në lidhje me artikullin sapun i lengshem per duart, Operatori Ekonomik duhet te paraqese Çertifikatë te aprovimit te testimit dermatologjik, Ieshuar nga organizma te akredituara me qellim vertetimin e testimit dermatologjik.* Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ankimesi KPP gjykon se Raport Studimi në gjuhën angleze e përkthyer në gjuhën shqipe vërtetuar me vërtim përkthimi noterial - Testim tek njerëzit për përshtatshmërinë me lëkurën i një produkti kozmetik pas përdorimit të vetëm –Testim mostre nën kontroll dermatologjik-Qendra e Investigimit Evic France, është një dokument i skanuar në origjinal i cili është në përputhje me udhëzimin e APP i cili parashikon shprehimisht se *Dokumentat e skanuar duhet të jenë origjinal ose kopje e noterizuar, versioni i skanuar i këtyre dokumentave pasi hidhet ne sistemin e prokurimit elektronik, për një procedurë konkrete është i barasvlefshëm me dokumentin origjinal ose kopjen e noterizuar”.*

III.1.16. Sa më sipër analizuar, KPP gjykon se autoriteti kontraktor në vlerësimin e ofertave duhet të udhëhiqet nga parimi i mirëpërdorimit të fondeve publike dhe përfitimi i një produkti me cilësi të mirë dhe me çmim më të ulët, si edhe nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale duke dhënë argumenta të cilat në rastin konkret nuk qëndrojnë lidhur me mungesën e njehsimit me origjinalin të skedave teknike të prodhuesit dhe raport analizave të kërkuara ndërkohë që operatori ekonomik ka dorëzuar në sistem skeda teknike dhe raport analiza në origjinal dhe të përkthyer me vërtetim përkthimi para noterit.

Referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 66, autoriteti kontraktor në rastin konkret, nëse do të kishte dyshime apo do të ishte i paqartë, kishte të drejtë që të kërkonte sqarime apo të bënte verifikimet përkatëse, në mënyrë që të bënte një vlerësim të saktë dhe trajtim të barabartë dhe jo diskriminues të operatorëve ekonomikë.

Në këto kushte Komisioni pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të dorëzuar nga ankimesi në SPE katalogët teknike në gjuhën angleze dhe të përkthyer në gjuhën shqipe si dhe raport analizat dhe testin dermatologjik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga subjekti “W Center” sh.p.k në tërësi në përmbushje të kriteve 2.3.4 2.3.5, 2.37 është i vlefshëm për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Gjithashtu, operatori ekonomik “W.Center” sh.p.k ka dorëzuar edhe shtojcën 5 “Deklaratë mbi Përmbushjen e Specifikimeve Teknike”, ku ka deklaruar se “Përmbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.” K.P.P. gjykon se operatori ekonomik “W Center” sh.p.k me nënshkrimin e deklaratës së sipërcituar ka marrë përsipër realizimin e objektit të prokurimit sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Akoma më tej, komisioni i Prokurimit Publik sqaron se në bazë të nenit 62 “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës” të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenin 62 të LPP-së, si më sipër cituar.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues W Center qëndrojnë.

III.2. Në lidhje me pretendimin e BOE ankimues “Captain Din” shpk & “Gentian Horieti” p.f, për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se *Kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.3.1, operatori ekonomik Gentian Horieti, anëtar i këtij bashkimi operator nuk e përmbush këtë kriter. Kontratat e paraqitura për këtë kriter nga ky operator, kanë artikuj jo të ngjashëm, si dhe një kontratë nuk ka vërtetim realizimi. Vlera totale nga faturat tatimore dhe artikujt e ngjashëm objekt i këtij prokurimi, nuk e arrin përqindjen respektive të këtij operatori, për këtë kriter*”, Komisioni i prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Operatorët ekonomikë “Captain Din” shpk & “Gentian Horieti” kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomikë me anë të AKT Marrëveshjes nr.1604 rep nr.276 kol datë 30.06.2020 për realizimin e objektit “*Blerje materiale të nevojshme për mbrojtjen personale për përballimin e situatës të shkaktuar nga COVID-19*”. Në akt marrëveshje parshikohet se *pjesmarrja e palëve në grup do të përcaktohet sipas këtyre raporteve: Shoqëria Captain Din shpk 11% të sasisë totale të artikujvesi dhe merr përsipër transportin e produkteve me mjetet e veta. Personi fizik Gentjan Horjeti 89% të sasisë totale të artikujve respektivë.*

III.2.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kritrei si më poshtë:

Operatori Ekonomik duhet te paraqese deshmi per furnizimet e meparshme, te ngjashme, te kryera gjate 3 (tre) viteve te fundit, nga data e zhvillimit te procedures, ne nje vlere jo me te vogel se 40 % e vleres se perllogaritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tre viteve te fundit.

- *Operatori ekonomik per te vertetuar pervojen e meparshme te realizuar me institucione shteterore duhet te paraqese kontrata te ngjashme per furnizime te shoqeruara me vertetim realizimi nga institucioni perkates (enti publik) per kontraten e realizuar.*
- *Operatori Ekonomik per te vertetuar pervojen e meparshme te realizuar me subjekte private duhet te paraqese faturat tatimore te shitjes, ku te shenohen datat, shumat, dhe sasite e mallrave te furnizuara.*

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektornike rezulton se anëtari i bashkimit “Gentian Horiet” pf në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim për realizim kontrate Nr.84 prot datë 18.01.2018 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit për kontratën me objekt Blerje unifroma dhe veshje speciale me vlerë 715 800 lekë pa tvsh, Kontratë nr.42/4 datë 15.012.2017 (aneksi nr. 1 sasia dhe llojet e mallrave jelek me mbushje pa mëngë, kominoshe verore, set ripa sigurimi për punëtorë skelerie, kapele me strehë, dorashka lëkure, dorashka gome, maska kundër pluhurit, maska për spërkatësit e DDD etj
- Vërtetim për realizim kontrate Nr.1896/1 prot datë 09.06.2020 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike për Kontratën me Nr.28/7 prot datë 16.07.2018 me objekt “Blerje Uniforma dhe Veshje Speciale” me vlerë 897,550 lekë pa tvsh, Kontratë Nr.28/7 prot datë 16.07.2018 (aneksi nr. 1 sasia dhe llojet e mallrave kapele me strehë, helmetë saldimi, helmetë mbrojtëse për kokën, gjysylykë transparentë, maskë për spërkatësit e DDD plus filtra, maskë kundra pluhurit njëpërdorishme, jelek i hollë veror, kominoshe verore, kominoshe për punë profesionale, pardesy për sanitare , bluzë verore, mushama shiu, doreza plastiketë thjeshta për sanitare)
- Vërtetim për Realizim Kontrate Nr.1102/1 prot datë 06.03.2020 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Objektve Publike për kontratën me objekt Bleje uniforma dhe veshje speciale me vlerë 1,895,785 lekë pa tvsh , Kontratë Nr.30/5 prot datë 02.12.2019 aneksi nr. 1 sasia dhe llojet e mallrave kapele me strehë, helmetë mbrojtëse për kokën, helmetë saldimi, helmetë mbrojtëse për kokën për punime në lartësi skelerie, gjysylykë transparentë, maskë kundra pluhurit me valvol, maskë për spërkatësit e DDD, jelek i hollë veror, kominoshe verore, përparëse për sanitare, kominoshe njëpërdorimshme, mushama shiu, bluzë verore, doreza profesionale, dorashka me teksturë dhe veshje e vecantë për saldator, doreza për preje xhami, doreza plastike, doreza plastike kundër kimikateve, çizme llastiku, këpucë pune me qafë, këpucë për skelë, pajisje sigurie për punime në lartësi, cantapër vegla pune, vaixhe për ndihmën e shpejtë, jelekë me mbushje pa mengë ne logo, bluzë dimri me push, rrip sigurimi mesi për punime në lartësi.
- Vërtetim Realizimi Nr.1799/1 datë 04.06.2020 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Objektve Publike për kontratën nr.6/8 prot datë 23.04.2020 me objekt “Blerje mjete pune për DDD” me vlerë 789,510 lekë pa tvsh, Kontratë nr.6/8 datë 23.04.2020 ,

Aneksi 1 sasia dhe llojet e mallrave Maskë respiratore profesionale kundër gazrave për mbrojtje gjatë proceseve të punës për DDD, Maskë respiratore karboni dolomite FFP2 për DDD, Cantë veglash ujëndaluese 20 L për DDD, Pompë elektrike/mekanike 20 litra , Xhel profesional anti viral bakterial për dezinfektim duarsh 500 ml për punonjësit e DDD, syze mbrojtëse ndaj kimikateve për punonjësit e DDD.

- Kontratë Nr. 1038 prot datë 30.03.2020 lidhur ndërmjet Gentjan Horjeti dhe Drejtoria e Përgjithshme e Pastrim Gjelbërimit me objekt Uniforma dhe Veshje Speciale me cmim total të kontratës 5,597,800 lekë pa tvsh. Sasia e mallit kominoshe, përparëse standart pune , mushama shiu, doreza saldimi prej lekure, doreza pune, çizme me nr.38 deri 44, këpucë me majë hekuri, pajisje mbrojtëse fytyre dhe veshi, jelek me logo me zinxhir, çizme të thjeshta, rrip sigurie, helmetë mbrojtësem syze mbrojtëse, kostume pune, këpucë pune, xhup pune me mëngë të gjata me logo, xhup pune pa mëngë, pantallona, bluzë me mëngë të shkurtra.
- Vërtetim për realizim kontrate Nr.1799/2 datë 04.06.2020 për kontratën me Nr. 6/10 prot datë 23.04.2020 me objekt Blerje veshje pune për DDD me vlerë 2,198,500 lekë pa tvsh, Kontratë Nr.6/10 prot datë 23.04.2020 , Aneksi nr.1 sasia e mallrave veshje speciale një përdorimshe, çizme kundër kimikateve për DDD, doreza plastike njëpërdorimshe, doreza profesionale kundër kimikateve për DDD, doreza të gomuaara për DDD, kominoshe pune profesionale për punime DDD, Maska mbrojtëse respiratore pambuku profesionale shumëpërdorimshe për punonjësit e DDD, maska mbrojtëse respiratore njëpërdorimshe.
- Vërtetim Realizimi Nr.1595/1 prot datë 09.06.2020 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit për kontratën me Nr.159/17 prot datë 08.04.2019 me objekt Uniforma të tjera dhe veshje speciale me vlerë 4,785,000 lekë pa tvsh, Faturë Tatimore Shitje Nr.26 datë 08.05.2019, sasia e mallit kominoshe, përparëse standart pune, mushama shiu, doreza saldimi prej lëkure, doreza pune, çizme, këpucë, pajisje mbrojtëse fytyre dhe veshi, jelek, çizme, rrip sigurie, helmetë, rrip sigurie, helmetë mbrojtëse, kostume pune, syze mbrojtëse, rrip sigurie, kostume pune, këpucë pune, pantallona, bluzë me mëngë të shkurtra, Kontratë Nr.159/17 prot datë 08.04.2019.
- Kontratë Nr.557/14 datë 18.04.2018 me objekt Uniforma dhe Veshje Speciale lidhur me Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit dhe Gentian Horieti me vlerë 3,275,833 lekë pa tvsh, sasia e mallit kominoshe, përparëse standart pune, mushama shiu, doreza saldimi prej lëkure, doreza pune, çizme , këpucë, pajisje mbrojtse fytyre dhe veshi, jelek me logo, çizme , rrip sigurie, helmetë mbrojtësem syze mbrojtëse, kostum pune, këpucë pune, xhup pune , pantallona. Shoqëruar me vertetim realizimi me nr.308/1 date 06.02.2019.
- Kontrata nr. 10/2 datë 21.05.2020 me objekt Blerje pajisje për mbajtjen e produkteve higjienizuese me vlerë 657,820 lekë pa tvsh sasia e mallit aparat për mbajtjen e letrës së duarve Z fold, vasketa inoksi për mbajtjen e lëndës dezinfektuese
- Fatura Tatimore Shitje me përshkrim sapun leng, blerje materiale pastrimi, ace lenor mastro lindo, fairy, në vlerën 1,187,770 lekë pa tvsh

- Fatura Tatimore Shitje me përshkrim veshje një përdorimshme, kominoshe, doreza nitrile, veshje speciale për DDD, doreza doreza nitrile, veshje një përdorimshme, xhel, maska, doreza në vlerën 476,416 lekë pa tvsh.

III.2.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.2.4. Neni 27 pika 4 “Kontratat e Mallrave” të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

- Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar mesektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.2.6. Referuar sa me sipër, nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga anëtari i bashkimit të përkohëshëm të operatorëve ekonomikë “Gentjan Horieti” pf në përmbushje të kriterit për përvojë të ngjashme, KPP vëren se kontratat e paraqitura kanë për objekt të tyre kryesisht uniforma dhe veshje speciale të cilat nuk mund të konsiderohen të një natyre të ngjashme me objektin e prokurimit.

Në sasinë dhe grafikun e lëvrimin bashkëngjitur kontratave të paraqitura, KPP vëren se vetëm një sasi shumë e vogël e mallrave të furnizuara mund të konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit sic mund të jenë dorezat, maskat mbrojtëse, detergjentë, kominoshe njëpërdorimshme, xhel profesional anti viral bakterial, syze mbrojtëse, pajisje mbrojtëse fytyre, veshje speciale një përdorimshme për DDD, çizme kunder kimikateve, kominoshe pune

profesionale, pajisje brojtje fytyre dhe veshi, syze mbrojtese, aparat per mbajtjen e letres se duarve, vasketa inoksi per mbajtjen e lendes dezinfektuese, doreza nitrile, veshje njeperdorimshe.

KPP pasi vecoi zërat e mallrave që mund të konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit si me siper cituar vëren se vlera e tyre nuk arrin të përmbushë vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor në kriterin e vecantë të kualifikimit në masën prej 40% të fondit limit në përputhje me përqindjen e marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit nga anetari i bashkimit te perkohshem te operatoreve Gentian Horieti pf ne respekt te nenit 74 pika 3 te VKM nr.914 date 29.12.2014 i ndryshuar.

Sa me siper KPP gjykon se anëtari i bashkimit Gentjan Horieti pf me dokumentacionin e paraqitur nuk provon se ka kryer furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit duke mos plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme, pasi kontratat e paraqitura permbajne zera te cilat nuk jane te ngjashem me objektin e prokurimit dhe ato zera qe KPP i konisderoi te ngjashem nuk mjaftojne per te plotesuar vleren e kerkuar ne perputhje me perqindjen e marre persiper ne kontraten e bashkpunimit. Akoma me tej KPP veren se Kontrata Nr. 1038 prot datë 30.03.2020 lidhur ndërmjet Gentjan Horjeti dhe Drejtoria e Përgjithshme e Pastrim Gjelbërimit me objekt Uniforma dhe Veshje Speciale me cmim total të kontratës 5,597,800 lekë pa tvsh nuk rezulton te jete shoqeruar me vertetim realizmi nga enti publik cka e ben ate te jete ne mosperputhje me kerkesat ne kriterin e vecante te kualifikimit.

Komisioni gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa më sipër pretendimi i BOE ankimes nuk qëndron

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “W Center” shpk për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me nr.REF-58793–05–21–2020, me objekt “*Blerje materiale të nevojshme për mbrojtjen personale për përballimin e situatës të shkaktuar nga COVID-19*”, me fond limit 37 546 021 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 02.07.2020 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Gentian Horiet” P.F& “Captain Din” shpk për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “W Center” shpk duke e kualifikuar atë.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “W Center” shpk.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 881 Protokolli; Datë 05.08.2020

Nr. 901 Protokolli; Datë 10.08.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri

